

MA Fikrie BERISHA

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës

KRIJIMTARIA LETRARE DHE ARTISTIKE E TË BURGOSURVE POLITIKË SHQIPTARË NË JUGOSLLAVI

Përmbledhje: *Krijimtaria të burgosurve politikë në fusha të ndryshme si: poezi, prozë, pikturë, pastaj letërkëmbime, skica, fotografi etj. nëpër burgjet jugosllave me kalimin e kohës ka marrë edhe vlerën e dokumenteve arkivore. Ky material dokumenton shqetësimin, idealin dhe sakrificën e njerëzve atdhetarë të cilët vuanin burgun politik për shkak të idealeve kombëtare që kishin. Zbardhja dhe evidentimi i këtij dokumentacioni është një kontribut i rëndësishëm për historinë kombëtare sepse merr peshën e një materiali arkivor të vlefshëm për brezat e ardhshëm dhe historiografinë tonë. Ky material është krejtësisht i veçantë për shkak të rrethanave dhe specifikave në të cilat është krijuar, prandaj edhe mbartë me vete atë që quhet “vulë e kohës”.*

Një pjesë e kësaj pasurie arkivore tashmë është bërë pjesë e fondeve të arkivave tona shtetërore. Nga ana tjetër, një pjesë e tyre është bërë publike përmes shkrimeve në revista dhe gazeta të ndryshme, kryesisht poezia dhe proza e shkurtër, ndërkohë që pjesa tjetër është publikuar në formë të librave tematikë dhe me kujtime nga koha e burgut etj.

Këto dokumente së bashku plotësojnë kriterin e dokumenteve dhe lëndës arkivore e cila duhet të sistemohet dhe trajtohet si koleksion/fond i veçantë me rëndësi për kujtesën politike kombëtare. Evidentimi, grumbullimi, ruajtja dhe pasqyrimi i kësaj krijimtarië për publikun, përveç të tjerash, për brezat e ardhshëm do të jetë një material arkivor mjaft i rëndësishëm si dëshmi e një kohe dhe periudhe të historisë sonë drejt përpjekjes për liri.

Angazhimi ynë për trajtimin e këtij materiali ka për synim të vë theksin mbi rëndësinë e hulumtimit, më pastaj studimit të kësaj krijimtarië me rëndësi historike, shkencore, letrare, artistike e politike.

Fjalë çelës: *Të burgosur politikë, krijimtari artistike, dokument arkivor, kujtesë kombëtare, historiografi etj.*

LITERARY AND ARTISTIC CREATIVITY OF ALBANIAN POLITICAL PRISONERS IN YUGOSLAVIA

Abstract: *The creativity of political prisoners in various fields such as: poetry, prose, painting, then correspondences, sketches, photographs, etc. in Yugoslav prisons, over time it has also acquired the value of archival records.*

This material documents the concern, ideal, and sacrifice of patriotic people who suffered political imprisonment because of the national ideals they held. The exposure and recording of this documentation is an important contribution to national history, as it takes on the weight of a valuable archival material for future generations and our historiography. This material is quite special, due to the circumstances and specificities in which it was created, thus it carries with it what is called the "seal of time".

A part of this archival property has already become part of the fonds of our State Archives,

On the other hand, some of them have been made public through articles in various magazines and newspapers, mainly poetry and short prose, while the rest have been published as thematic books and memories from prison time, etc.

These documents, together, meet the criteria of archival records and material, which should be arranged and treated as a special collection/fonds important for the national political memory

Recording, collection, preservation and reflection of this creativity for the public, among others, for future generations will be a very important archival material, as evidence of a time and period of our history towards the struggle for freedom.

Our commitment to the treatment of this material, aims to emphasize the importance of research and then the study of these archival materials of historical, scientific, literary, artistic and political importance.

Keywords: *Political prisoner, artistic creativity, archival records, national memory, historiography, etc.*

1. Hyrje

Edhe pas përfundimit të Luftës dytë Botërore (LDB), pavarësisht se dha shumë mund, kontribuoi dhe sakrifikoi shumë, Kosova nuk fitoi lirinë e saj. Ajo u ripushtua nga sllavo-komunistët të cilët luajtën lojën e mashtrimit kundruall shqiptarëve. Edhe periudha e viteve shtatëdhjetë e shekullit të kaluar, në Kosovë, e cila për shumëkënd konsiderohej njëfarë lirie e prosperiteti, në realitet nuk ishte ashtu; në esencë ishte veç një iluzion dhe një mashtrim. Statusi politik nuk ishte zgjidhur drejt, edhe pse trumbetohej nga pushtetmbajtësit kinse çështja kombëtare e shqiptarëve ishte zgjidhur më së miri në kuadër të ish-federatës jugosllave. E vërteta ishte krejt ndryshe. Në përpjekjet për liri dhe barazi, për ndryshimin dhe avancimin e statusit të Kosovës nga aktivitetet atdhetare ilegale, por edhe përmes demonstratave të fuqishme, në shenjë represioni dhe ndëshkimi burgjet serbo-sllave ishin të mbushura me djem dhe vajza shqiptare, vetëm se kishin kërkuar barazi me republikat e tjera. Edhe pas arrestimit shqiptarët nuk ndaluan përpjekjen për të drejtat e tyre, por tashmë, në një mënyrë tjetër, në rrethanat që ua krijonte dhe lejonte burgju, ata filluan të shprehin pakënaqësinë e tyre përmes

shkrimeve dhe veprave të ndryshme artistike që krijojnë nëpër qelitë e burgjeve.

Prandaj, ky material arkivor është një krijimtari krejtësisht e veçantë. Quhet e veçantë për shkak të rrethanave dhe specifikave në të cilat është krijuar dhe, për këtë arsye, përveç të tjerash, mbartë me vete edhe atë që quhet *vulë e kohës*. Kjo krijimtari, përveç vlerave dokumentare, për shkak se është shkruar nëpër qelitë e burgjeve, ka edhe vlera letrare, artistike, pedagogjike dhe arsimore sepse, po t'i analizojmë me vëmendje, shohim se përmbajtja kryesore e tyre është e tillë. Prandaj, hulumtimi dhe studimi i krijimtarisë nga të dënuarit nëpër burgjet e ish-federatës jugosllave dhe të Serbisë, është me rëndësi të madhe shkencore, artistike dhe politike. Kjo krijimtari ka përmasat e vlerës së krijimtarisë kombëtare pasi krijimi i saj është bërë në rrethana shumë komplekse, në rrethana të një realiteti shumë të rëndë. Pra, janë krijime të cilat ngërthejnë në vete zjarrin, dritën e shpirtit dhe forcën e idealit të tyre për liri kombëtare dhe, si të tilla, paraqesin kujtesën kombëtare.

Struktura e punimit është përcaktuar nga forma dhe përmbajtja e gjinisë krijuese të dokumenteve (poezia, proza, piktura, letërkëmbimet, monografi të publikuara etj.), të të burgosurve politikë gjatë vuajtjes së tyre që i kemi emërtuar si dokumente të krijuara nga të burgosurit politikë gjatë vuajtjes së dënimit.

Të burgosurit politikë shqiptarë që kanë vuajtur dënimin në burgjet politike të ish-federatës jugosllave dhe më vonë të Serbisë janë një kategori e veçantë e veprimtarëve patriotë, me vetëdije të lartë politike dhe kombëtare, të cilët sakrifikonin në emër të kauzës së përgjithshme të lirisë dhe idealit për çlirim kombëtar. Kjo klasë prijëse e proceseve politike sublimonte dëshirat dhe aspiratat e të gjithë shqiptarëve.

2. Dokumentet arkivore të krijuara në kushtet e burgjeve

2.1. Burimet dhe fondet ekzistuese

Kjo krijimtari artistike dhe letrare, për ne lëndë arkivore, deri në ditët e sotme është bartur përmes rrugëve të ndryshme. Disa dokumente janë ruajtur nga bastisjet dhe sekuestrimet nëpër qelitë e burgjeve, disa nga koha e bastisjeve në momentet e arrestimeve, që janë marrë si prova materiale për veprimtari armiqësore ndaj sistemit politik dhe ish-federatës së vëllazërim-bashkimit. Ndërkaq një pjesë e tyre tashmë janë pjesë e fondeve të arkivave tona shtetërore, që janë dorëzuar në arkiv, si fonde të veçanta, nga ish-gjykatat e qarqeve, konkretisht Gjykata e Qarkut e Prishtinës, e Prizrenit, e Pejës, e Gjakovës, e Mitrovicës, e Gjilanit etj.

Një pjesë tjetër e tyre është bërë publike përmes shkrimeve në revista dhe gazeta të ndryshme. Ndërkaq, pjesa tjetër është publikuar në formë të librave

tematikë dhe me kujtime nga koha e burgut etj. Shembuj të tillë kemi botimin e librit të Hydajet Hysenit, *Paraverë në katër akte*¹, kryesisht me shkrime nga burgu. Librin e Martin Çunit, *Lulet e jetës*.²Pastaj, i shkruar në kushtet e burgut (1962) është edhe romani i botuar tash së fundmi i Adem Demaçit, “Drithë e miell bashkë”, Prishtinë, 2020.³

Nga analiza e materialeve që kemi pasur, nga aspekti i vendit dhe kohës së krijimit, rezulton se ekzistojnë dy lloj krijimesh gjatë kësaj periudhe që kanë për autorë të burgosurit politikë.

E para janë ato krijime që janë shkruar brenda mureve të qelive gjatë kohës së vuajtjes së dënimit të të burgosurve politikë. Në këtë kategori mund të hyjnë, p. sh., krijimet e Hydajet Hysenit, Adem Demaçit, Martin Çunit, Merxhan Avdyllit etj.

Krijimet e autorit Bedri Zyberaj, poetit të orëve të para të luftës për liri dhe viktimitë e demokracisë së absurditetit, e cila vazhdon të merret me akuzimin dhe gjykimin e luftëtarëve të lirisë, sikur do të na vërtetojnë thënien e pushtuesit, se *burgu është vendi i paracaktuar për shqiptarët!*

E dyta, janë ato krijime të cilat u konfiskuan, më saktë u burgosën së bashku me autorët (pronarët) e tyre. Fatkeqësisht, këtë lloj krijimtarie e njohim më pak dhe qasja në këto dokumente është më e vështirë me gjithë frikën se mos janë asgjësuar gjatë kohës së shkuar. Këtu mund t'i përmendim krijimet e Ismet Ramadanit, ish i burgosur, të cilat janë të shumta si: poezi, prozë e shkurtër, ditar, pastaj letërkëmbime të tij që mban me shokët që ishin burgosur, deri te të ashtuquajturat leksikone që mbanin gjeneratat e asaj kohe si nxënës, të gjimnazit.⁴

Ky material është bërë pjesë e fondit të arkivave përmes gjykatave relevante të kohës të cilat ia kanë dorëzuar arkivit si fonde të veçanta dhe sot vazhdojnë të jenë pronë e institucionit të arkivit siç është, p. sh., Fondi i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë, në Arkivin Qendror të Kosovës dhe gjykatave të tjera nëpër arkivat relevante ndërkomunale të Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Gjakovës dhe Gjilanit.

Është me rëndësi të theksohet se gjatë përpunimit të materialit burimor për temën hasim krijues të cilët mund t'i shohim në dy e më shumë fusha krijuese siç është, p. sh., Hydajet Hyseni, i cili shkruan letra me prozë, poezi, por që ka bërë edhe skica, pastaj Sylë Mujaj, i cili, po ashtu, shkruan poezi, njëkohësisht edhe skica dhe vizatime të ndryshme ose Martin Çuni që ka shkruar poezi, letra të shoqëruara me ilustrime të ndryshme dhe pikturë, Emrush Xhemajli që ka pikturuar në vaj, por ka provuar edhe skulpturën në kushtet e qelisë etj. E përbashkëta e këtyre krijimeve është se plotësojnë kriterin e dokumenteve dhe lëndës arkivore, e cila duhet sistemuar si fond i

¹ Hydajet Hyseni. 2006. *Paraverë në katër akte*. Prishtinë.

² Martin Çuni. 2019. *Lulet e Jetës*. Prishtinë. Radio Kosova e Lirë.

³ Adem Demaçi. 2020. *Drithë e miell bashkë*. Prishtinë.

⁴ *Gjykata e Qarkut*, Prishtinë, nr. invent. 80, viti 1980, kutia, nr. 31, Dosja nr. 142/80.

veçantë, me rëndësi për kujtesën politike kombëtare, sepse është pasqyrim i gjithë aspiratave të shqiptarëve të një kohe sa dramatike aq dhe të lavdishme.

2.2. Letërkëmbimet

Letërkëmbimi është forma e shkrimit më e përhapur në burg pasi pothuajse të gjithë të burgosurit kanë mbajtur korrespondencë nga burgu. Karakteri dhe përmbajtja e këtyre letrave (letërkëmbimeve) është e ndryshme, si: letra familjare, ankesa të të burgosurve ndaj organeve të sigurimit, peticione të ndryshme etj. Kështu, p. sh., një kategori e të burgosurve, duke iu drejtuar një familjari përmes letrave, shprehnin pikëpamjet e tyre politike për kohën. Një tjetër ka shkruar poezinë ose tregimin që e ka inkorporuar në kuadër të përmbajtjes së letrës.

Krahas letrave me përmbajtje artistike, ka ndodhur që poeti të shkruajë letra politike siç është rasti me poetin Besim Zymberi, i cili ka shkruar dy vëllime me poezi prapa grilave të burgjeve serbe. Por ajo që do të përmendim me këtë rast nuk është poezi, por një letër personale që e shkruan gjatë kohës sa ishte i mbyllur në qeli, të cilën arrin ta nxjerrë nga burgu dhe ia përcjell shkrimtarit Ismail Kadare, të cilin e porosit që t'ia dorëzojë presidentit të atëhershëm francez Zhak Shirak.⁵ Kjo letër u shkrua me qëllim që bota ta kuptonte se Serbia ende po vazhdonte të mbante shumë shqiptarë nëpër burgje dhe ta ushtronin presionin mbi shtetin serb ose, p. sh., një kartolinë e dërguar një familjari nga i burgosuri politik i kohës, Fehmi Lladrovci.⁶

Pastaj, kemi letrat me karakter politik, ku janë shprehur pikëpamjet politike nga burgu për zhvillimet e përgjithshme politike jashtë, siç janë, p. sh., letrat e Ukshin Hotit drejtuar motrës së tij, Myrvetes. Ato duan trajtim të veçantë.⁷

Dërgimi i këtyre letrave është bërë herë përmes rrugës zyrtare, herë përmes rrugëve të fshehta. Shumë prej tyre kanë mbërritur në duart e familjarëve, por ka edhe të tilla që janë nxënë nga policia e burgut dhe, si të tilla, janë futur në dosjet e të burgosurve, p.sh., kemi një letër të Martin Çunit dërguar vajzës së tij, Teutës.⁸

Letrat e Martin Çunit të mahnitin me bukurshkrimin e tyre, ndjenjën e fuqishme që i përshkon gjatë gjithë kohës, por edhe skicat e ndryshme që përdor si ilustrim në letra.⁹

⁵ <https://archive.koha.net/?id=&l=156442/20.07.2020/>.

⁶ <https://www.facebook.com/fehmiu.dhe.xheva/photos/letra-e-fehmi-lladrovci-derguar-lumbardh-zariqit-nga-burgu-ne-kroaci-qe-ua-uroi/1116414301732403/> / 27.09.2020/.

⁷ Ukshin Hoti, Letra Myrvetes nga burgu i Nishit1, <https://www.mekulipress.com/ukshin-hoti-letra-myrvetes-nga-burgu-i-nishit-1-6-korrik-1997/> / 27.09.2020/.

⁸ Martin Çuni. 2019. *Lulet e Jetës*. Prishtinë. Radio Kosova e Lirë, f. 72, 73, 74.

⁹ Martin Çuni. 2019. *Lulet e Jetës*. Prishtinë. Radio Kosova e Lirë, f. 50, 51.

Kemi, po ashtu, letërkëmbime që janë mbajtur mes shokësh që ishin jashtë burgut me ata të cilët ishin burgosur, p. sh., rastin e Ismet Ramadanit i cili komunikon me bashkëveprimtarin e tij, Mehmetali Rexhepin¹⁰, i cili në atë kohë ishte i burgosur.

Përmes këtij letërkëmbimi ata i informonin shokët në burg për situatën dhe gjendjen që mbretëronte jashtë. U jepnin informacion edhe për arrestimin e shokëve të tjerë me qëllim që të ishin në dijeni dhe të dinin si të mbanin qëndrim pastaj para organeve të hetuesisë që po i torturonin shumë. Nga ana tjetër, trajtoheshin hollësisht edhe shqetësimet familjare gjatë përbaljes me jetën, ekzistencën dhe rrethanat politike.¹¹

Një element shumë i veçantë dhe i pranishëm pothuajse në çdo letër që shkruajnë, është brenga e tyre për familjarët që kishin lënë në shtëpi e sidomos brenga rreth edukimit të fëmijëve të cilët po rriteshin pa praninë e babait. Prandaj, në çdo letër nuk mungonte asnjëherë porosia që u bënin fëmijëve që të mësonin, të bëheshin fëmijë të mirë dhe të sjellshëm, të dëgjonin nënën e tyre që po përkujdesej e vetme për ta, t'u dëgjonin gjyshërit e tyre nëse i kishin gjallë dhe që të lexonin sa më shumë libra, bile edhe jashtë obligimeve shkollore që mund të kishin.¹²

Temën e letrave nga burgu, korrespondencën me familjet, shokët dhe rrethin më të gjerë, më së miri e kanë trajtuar dy autorë, të cilët edhe vetë kanë qenë të burgosur politikë, Merxhan Avdyli dhe Bajram Kosumi në librin *Letra nga burgu: libri i censuruar*.¹³

Stili i shkrimit të këtyre letrave edhe kur kanë qenë legale dhe të fshehta ka qenë i koduar dhe karakterizohet me simbolika, alegori dhe figuracione të ndryshme. Interesant është fakti, kur formulimi i fjalëve dhe fjalive bëhej duke përdorur shkronjat e librave që ua sillnin për t'i lexuar. Këto letra sot janë një dëshmi e mirë e një kohe të shkuar, e cila tregon përkushtimin e lartë të autorëve për çështjen kombëtare, familjen, shokët dhe miqësinë, mbi të gjitha për të ardhmen e përbashkët për të cilën mendonin se duhej bërë të pamundurën, vetëm që të arrihej liria dhe barazia me kombet tjera.

2.2.1. Pikturat dhe skicat

Përveç poezisë, prozës e veprave të tjera, disa nga të burgosurit kanë pasur talent për pikturë dhe skica të ndryshme. Ata shpesh bënin portrete të shokëve, piktura, punime me pamje të ndryshme të ambienteve të burgut, duke u munduar që të fiksojnë ndonjë çast me rëndësi nga jeta e tyre nëpër

¹⁰ Arkivi i Kosovës, Fondi: Gjykata e Qarkut, Prishtinë, viti 1980, Dosja nr. 142/80, kutia nr. 31.

¹¹ Marrë nga arkivi personal i të burgosurit Ibrahim Shala.

¹² Marrë nga arkivi personal i të burgosurit Martin Quni.

¹³ Merxhan Avdyli, Bajram Kosumi, 2004, *Letra nga burgu: libri i censuruar*, Prishtinë, Brezi '81.

qelitë e burgjeve. Shumica prej këtyre krijimeve kanë arritur të dalin nga burgjet dhe pastaj janë publikuar në shtypin e kohës. Kurse një pjesë e tyre ka ngelur në dosjet e të burgosurve, sepse zyrtarët e burgu kanë vlerësuar se nuk duhet të dalin jashtë mureve. Në vijim po sjell një autoportret të punuar nga Fikrije Musa¹⁴, të burgosurit Hydajet Hyseni¹⁵ dhe Sylë Mujaj.¹⁶

Këto vizatime dhe skica brenda ambienteve të qelive na japin pamje të ruajtura për një kohë dhe një moshë të të burgosurve, si mund të jenë dukur ata në një rrethanë dhe kohë të caktuar.

2.2.2. Fotografitë

Në burgjet jugosllave, më vonë edhe të Serbisë, fotografimi i të burgosurve politikë ka qenë shumë i rrallë. Për këtë arsye ka shumë pak fotografi nga jeta e burgut të të burgosurve politikë. Numri i fotografive varej kryesisht nga situata e përgjithshme politike dhe republika (shteti) ku kanë qenë duke e vuajtur dënimin. Ka raste kur shtypi shtetëror ka bërë ndonjë intervistë me ndonjë të burgosur politik dhe me atë rast i është publikuar edhe fotografia. Kanë ngelur fotografi nga seancat gjyqësore¹⁷ që kanë marrë vlerë historike, por ka edhe nga ato që kanë mundur të mbijetojnë nga jeta brenda burgut¹⁸ e që janë të rralla. Megjithatë, mbas çlirimit është publikuar një numër i konsiderueshëm i fotografive, kryesisht fotografi nga gjykatat, pra kur bëhej gjykimi i të burgosurve etj.

2.2.3. Poezitë

Mënyrat e kundërshtimit të dhunës dhe padrejtësisë së asaj kohe ishin nga më të ndryshmet. Përveç angazhimit dhe organizimit ilegal, kundërshtimi i pushtetit bëhej edhe përmes krijimit të artit, p. sh., poezisë, prozës, pikturës (karikaturës) etj. Një ndër më të spikaturit në krijimin e poezisë është Hydajet Hyseni. Këtë e dëshmon publikimi pas daljes nga burgu i përmbledhjes me poezi *Paraverë në katër pamje*, botuar në Prishtinë më 2006. Përmes këtyre poezive autori sulmon kryesisht pushtetin okupues, anomalitë e sjelljes së tij, protagonistët e ndryshëm të pushtetit etj. Po ashtu, poeti i këndon mallit për atdheun, e sidomos nënës - krijesës më të dashur në botë. Këtë më së miri e ilustronë vargjet e poezisë së tij *Qan Kosova për bijtë e saj*, përmes së cilës autori në mënyrë të mrekullueshme paraqet dhimbjen e

¹⁴ Gjykata e Qarkut, Prishtinë, viti 1989, nr. i inventarit 80, kutia nr. 5, Dosja, nr. 15/89.

¹⁵<https://www.facebook.com/Vizatime-e-poezi-nga-burgu-274419593830/27.09.2020/>.

¹⁶<https://www.facebook.com/Vizatime-e-poezi-nga-burgu-274419593830/27.09.2020/>.

¹⁷ <http://floripress.blogspot.com/2011/04/nga-flori-bruqijeta-dhe-vepra-hydajet.html/>

¹⁸ <https://diskutime-shqiptare.albanianforum.net/t2829-sheradin-berisha-ne-goli-otok-18.09.2020>.

ndarjes së nënës me të birin, të cilët edhe mund të vdisnin pa e parë kurrë më njëri-tjetrin.

Një pjesë e konsiderueshme e këtyre poezive pas çlirimit janë botuar në shtypin e kohës, por ka prej tyre që edhe janë zhdukur ose janë konfiskuar nga policia e burgut. Këtë fat kanë pasur edhe poezitë e të burgosurit politik Hajdin Abazi.¹⁹ Përgjithësisht, janë poezi që shprehin shqetësimin dhe trazimin shpirtëror të burgosurve politikë për zhvillimet në Kosovë.

Në vitin 1991 *Zëri* botoi antologjinë me poezi nga burgu, *Libri i lirisë*, të pesë poetëve: Merxhan Avdyli, Ismail Syla, Hydajet Hyseni, Jonuz Jonuzaj dhe Bajram Kosumi. Ky libër paralajmëronte një fakt të ri letrar: letërsinë nga burgu. Një vlerësim të saktë kësaj veprimtarie i bën krijuesi dhe i burgosuri politik Ahmet Qeriqi, i cili këtë lloj krijimtarie e ka pagëzuar si *Letërsia e krijuesve të rezistencës kombëtare*, krijuesit me prejardhje nga Lëvizja e Rezistencës në Kosovë, ish të burgosurit politikë. Krijuesit nga radhët e Lëvizjes së Fshehtë Revolucionare (e njohur si Lëvizja Ilegale) janë të shumtë, si në Kosovë ashtu edhe në viset e tjera shqiptare nën pushtimin jugosllav. Ata fillet e tyre krijuese i kishin mbështetur te letërsia realiste me nota sociale, me qëllim që edhe krijimtaria e tyre artistike dhe diskursi revolucionar të ndikonte në formësimin dhe kalitjen e ndërgjegjes kombëtare, me synim për çlirimin dhe bashkimin e kombit.²⁰

Sigurisht që poezia, si një zhanër poetik krejtësisht i veçantë, e cila shpreh fuqishëm botën e brendshme të njerëzve me ideale të mëdha, është shkruar nga shumë të burgosur politikë dhe është e pamundur që ajo të përmbledhet e tëra dhe të publikohet përmes një punimi të këtij formati. Por, sigurisht që në të ardhmen do ta gjejë rrugën e saj të publikimit qoftë përmes mediave sociale apo publikimit të kujtimeve të ish të burgosurve politikë dhe formave të tjera dhe do të dalë në dritë.

2.3. Publikimet

Pas çlirimit të Kosovës shumë të burgosur politikë kanë publikuar përmbledhje me poezi nga koha e vuajtjes së dënimeve nëpër burgje, libra me kujtime nga burgu, por edhe studime të veçanta për burgjet e caktuara. Por, ne jemi fokusuar kryesisht te krijimtaria artistike e publikuar përmes librave tematikë. Ndër më të njohurit janë: Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu: kapitull më vete në letërsinë shqipe*, Tiranë, 2006; Martin Çuni, *Lulet e jetës*, Prishtinë, 2019; Adem Demaçi, *Drithë e miell bashkë*, Prishtinë, 2020; Hydajet Hyseni, *Paraverë në katër pamje*, Prishtinë, 2006; Merxhan Avdyli dhe të tjerët, *Libri i lirisë*, Prishtinë, 1991; Sylë Mujaj, *Shpirti i mendimeve*,

¹⁹ Gjykata e Qarkut, Prishtinë, nr. i inventa. 80, viti 1980, kutia, nr. 3, Dosja nr. 142/80.

²⁰ <https://www.radiokosovaelire.com/ahmet-qeriqi-kultura-dhe-letersia-shqiptare-ne-kosove-perballe-hegjemonizmit-kulturor-serb-e-jugosllav-ii/27.09.2020/>.

ShBA, 2011; Merxhan Avdyli, Bajram Kosumi, *Letra nga burgu: libri i censuruar*, Prishtinë, 2004 dhe shumë të tjerë.

Duke parë rritjen e volumit të botimit të këtyre publikimeve, si zhanër i posaçëm i krijimit të artit, është emërtuar si *Letërsi nga burgu*. “Ato paraqesin prova këmbëngulëse për diskutim të mëtejshëm për vendin e kësaj letërsie në historinë e letërsisë shqipe: si dokument apo si poetikë e dokumentit; si kohë apo si hapësirë e krijimit; si letërsi që është krijuar dhe në mënyrën e vet ka bërë edhe një ‘jetë të saj’ në burg apo, si sociologji e tekstit; si pjesë vëllimore e letërsisë shqipe që duhet të botohet; apo, si letërsi që ka pasur botën e saj të brendshme. Pra, një letërsi e re, një pjesë e panjohur e letërsisë së sotme shqipe apo një letërsi e pabotuar, që duhet t’i bashkohet vëllimit letrar të letërsisë shqipe”.²¹ Prandaj, këto lloj krijimesh, kudo dhe në çfarëdo forme që janë publikuar, për shkak të rëndësisë që kanë, si dëshmi e aktivitetit të tyre gjatë vuajtjes së dënimit në burg, pa dyshim se marrin rëndësinë e dokumenteve historike dhe duhet të trajtohen si të tilla.


3. Përfundim

Lënda arkivore e krijuar nga të burgosurit politikë, si krijimtari artistike dhe intelektuale, paraqet fond më vete të dokumenteve me rëndësi historike, kombëtare, arkivore dhe profesionale; dokumente të cilat përmes publikimeve dhe botimeve të veçanta, janë shndërruar në pronësi publike, shoqërore dhe kombëtare. Këto materiale, si të tilla, në tërësinë e tyre duhet të arkivohen si fonde të posaçme me emërtim të caktuar dhe të saktë nëpër arkivat shtetërore. Konsideroj se do të ishte veprim i logjikshëm dhe i domosdoshëm sikur edhe publikimet e posaçme të librave tematikë, monografitë, kujtimet e shkruara etj., të trajtoheshin dhe pranoheshin si të barasvlershme me dokumentet arkivore, pra si lëndë arkivore, pavarësisht se ato në të njëjtën kohë gjenden edhe nëpër biblioteka publike ose arkiva digjitale të individëve që i kanë krijuar ato. Këto dokumente, sot, në format e tyre ekzistuese, marrin rëndësinë e veçantë si burim informacioni, i cili plotëson një vakum historik përmes dokumenteve që janë shkruar/krijuar brenda mureve të qelive, hëm brenda e hëm jashtë territorit të Kosovës.

²¹ Myrvete Dreshaj-Baliu, *Vepra e Bajram Kosumit*, <https://rajonipress.com/vepra-shkencore-e-bajram-kosumit/20.07.2020>.




1. Ballina e librit të Hydajet Hysenit, *Paraverë në katër akte*
2. Ballina e librit të Martin Çunit, *Lulet e jetës*






1. Ballina e librit të Adem Demaçit, *Drithë e miell bashkë*
2. Ballina e librit e Bedri Zyberajt, *Vdekje më të mirë nuk dua*




1. Poezi e Hydajet Hysenit botuar në librin *Paraverë në katër pamje*, Prishtinë, 2006
2. Poezi e Martin Çunit botuar në librin *Lulet e jetës*, Radio Kosova e Lirë, 2019






Faksimile të Ismet Ramadanit




1. Letra e Besim Zybmerit drejtuar kryetrarit të Francës
2. Letra e Fehmi Lladrovciit dërguar Lumbardh Zariqit





Faksimile të letrave të ilustruara të Martin Çunit dërguar vajzës dhe djalit



Faksimile të letrave të Martin Çunit dërguar vajzës




Faksimile të letrave të Ismet Ramadanit dërguar Mehmetali Rexhepit




Ibrahim Shala, letër drejtuar motrës



1. Syle Mujaj: I burgosuri duke lexuar gazetën
2. Hydajet Hyseni: Duke lexuar gazetën së bashku




1. Fikrije Musa: *Autoportret*
2. Hydajet Hyseni: *Dhomë burgu*



Fotografi gjatë seancave gjyqësore



Foto nga burgu i Goli Otokut



Faksimile të poezive në dorëshkrim të Hajdin Abazit

3. Bibliografi:

- Avdyli, Merxhan... [et al.]. (1991). *Libri i lirisë, Zëri*. Prishtinë.
- Avdyli, Merxhan; Kosumi, Bajram. (2004). *Letra nga burgu: libri i censuruar. Brezi '81*. Prishtinë.
- Çuni, Martin. (2019). *Lulet e Jetës*. Radio Kosova e Lirë. Prishtinë.
- Demaçi, Adem. (2020). *Drithë e miell bashkë*. Prishtinë.
- Hyseni, Hydajet. (2006). *Paraverë në katër akte*. Prishtinë.
- Kosumi, Bajram. (2006). *Letërsia nga burgu: kapitull më vete në letërsinë shqipe*. Toena. Tiranë.

Mujaj, Sylë. (2011). *Shpirti i mendimeve*, ShBA
Zyberaj, Bedri. (2018). *Vdekje më të mirë nuk dua. Armagedoni*. Prishtinë.

Dokumente arkivore:

Arkivi i Kosovës, Fondi: Gjykata e Qarkut, Prishtinë, viti 1980, dosja nr. 142/80, kutia nr. 31
Gjykata e Qarkut, Prishtinë, viti 1989, nr. i inventarit 80, kutia nr. 5, dosja, nr. 15/89
Gjykata e Qarkut, Prishtinë, nr. i inventarit 80, viti 1980, kutia nr. 3, dosja nr. 142/80

Burime nga interneti:

Myrvete Dreshaj-Baliu, Vepra e Bajram Kosumit,/ <https://rajonipress.com/vepra-shkencore-e-bajram-kosumit/> 20.07.2020
Ukshin Hoti, Letra Myrvetes nga Burgu i Nishit – 1, <https://www.mekulipress.com/ukshin-hoti-letra-myrvetes-nga-burgu-i-nishit-1-6-korrik-1997/> 27.09.2020/
<https://www.facebook.com/fehmiu.dhe.xheva/photos/letra-e-fehmi-lladrovcit-derguar-lumbardh-zariqit-nga-burgu-ne-kroaci-qe-ua-uroi/1116414301732403/> 27.09.2020/
<https://www.radiokosovaelire.com/ahmet-qeriqi-kultura-dhe-lettersia-shqiptare-ne-kosove-perballe-hegjemonizmit-kulturor-serb-e-jugosllavii/> 27.09.2020/
<https://archive.koha.net/?id=&l=156442/> 20.07.2020/
<https://www.facebook.com/Vizatime-e-poezi-nga-burgu-274419593830/> 27.09.2020/
<https://diskutime-shqiptare.albanianforum.net/t2829-sheradin-berisha-ne-goli-otok>

